

LIGJI NR. 08/L-230

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
REPUBLIKËS SË SLLOVENISË MBI EKSTRADIMIN**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
REPUBLIKËS SË SLLOVENISË MBI EKSTRADIMIN**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë mbi ekstradimin, të nënshkruar nga Ministrat e Drejtësisë të të dy vendeve më datë 28.10.2016 në Slloveni.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj vlen për të gjitha organet e administratës shtetërore dhe organet gjyqësore në Kosovë që janë përgjegjëse për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

**Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura**

Në shtojcën e këtij ligji është bashkëngjitur teksti i Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë mbi ekstradimin.

**Neni 4
Hyrja në fuqi**

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-230
8 qershor 2023**

Shpallur me dekretin Nr. DL-116/2023, datë 22.06.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

*Ligji nr. 08/L-230 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë mbi ekstradimin", bashkëngjitur me marrëveshje janë publikuar në web faqen e Gazetës Zyrtare (gzk.rks-gov.net)

MARRËVESHJE
NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
REPUBLIKËS SË SLLOVENISË
MBI
EKSTRADIMIN

Republika e Kosovës dhe Republika e Sllovenisë (më tej "Palët"), me dëshirën për të forcuar më tej bashkëpunimin në fushën e ndihmës juridike në çështjet penale, dhe në veçanti për të rregulluar bashkëpunimin në çështjet e ekstradimit,

janë pajtuar me sa vijon:

Obligimi për Ekstradim
Neni 1

Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Palët zotohen që sipas kërkesës, të ekstradojnë personat të cilët në vendin i cili kërkon ekstradimin (më tej "Shteti Kërkues") ndiqen penalisht për vepra penale apo ekstradimi i të cilëve kërkohet për ekzekutim të dënimit për heqje lirie.

Kanalet e Komunikimit
Neni 2

- (1) Në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet përgjegjëse të Palëve do të komunikojë me shkrim - Republika e Kosovës përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe Republika e Sllovenisë përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Sllovenisë.
- (2) Nuk do të përjashtohen kanalet diplomatike nëse ka baza të arsyeshme për një gjë të tillë.
- (3) Në raste urgjente, autoritetet përgjegjëse të secilës palë mund t'i dërgojnë kërkesat dhe njoftimet sipas kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL).

Gjuha dhe Legalizimi
Neni 3

- (1) Kërkesat dhe dokumentacioni duhet t'i paraqiten Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe, serbe, apo gjuhën angleze dhe Republikës së Sllovenisë në gjuhën sllovene apo angleze.
- (2) Legalizimi i dokumenteve nga paragrafi 1 i këtij neni nuk është i nevojshëm.

Dokumentacioni Neni 4

Kërkesës për ekstradim duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

1. Të dhënat për përcaktimin e identitetit të personit ekstradimi i të cilit kërkohet (një përshkrim i saktë, fotografitë, shenjat e gishtërinjve dhe të ngjashme);
2. një certifikatë apo të dhëna të tjera që konfirmojnë shtetësinë e personit ekstradimi i të cilit kërkohet;
3. origjinali ose kopja e vërtetuar e urdhrin për dënim apo paraburgim, i cili përfshijë si në vijim: emrin dhe mbiemrin e personit ekstradimi i të cilit kërkohet, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për të përcaktuar identitetin e personit, përshkrimin e aktit të kryer, cilësimin juridik të veprës penale dhe provat që dëshmojnë shkakun e arsyeshëm për dyshim;
4. një ekstrakt nga ligji penal përkatës i zbatueshëm për rastin e ekstradimit;
5. të dhënat në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit që duhet vuajtur.

Dokumentacioni Shtesë Neni 5

(1) Nëse të dhënat dhe dokumentacioni i dërguar nga Shteti Kërkues është i pamjaftueshëm, shteti nga i cili është kërkuar ta bëjë ekstradimin (më tej "Shtet i Kërkuar") mund të kërkojë të dhëna dhe dokumentacion shtesë dhe mund të përcaktojë një afat të arsyeshëm kohor për pranimin të tij.

(2) Shteti i Kërkuar menjëherë ndërprejë procedurën e ekstradimit dhe liron personin ekstradimi i të cilit kërkohet, nëse të dhënat dhe dokumentacioni i kërkuar shtesë nuk pranohet brenda afatit të përcaktuar.

Veprat Penale të Ekstradueshme Neni 6

(1) Ekstradimi lejohet për qëllime të ndjekjes penale në lidhje me veprat penale të dënueshme sipas ligjeve të Shtetit Kërkues dhe të Shtetit të Kërkuar për dënim heqjetë lirisë për një periudhë minimale prej të paktën një viti.

(2) Lejohet ekstradimi për zbatimin e një vendimi të formës së prerë në lidhje me veprat penale të dënueshme sipas ligjeve të Shtetit Kërkues dhe të Shtetit të Kërkuar dhe nëse kohëzgjatja e pjesës së mbetur të dënimit me heqje lirie është të paktën katër muaj.

(3) Nëse kërkesa për ekstradim përfshin disa vepra penale të ndara, secila prej të cilave është e dënueshme sipas ligjeve të Shtetit Kërkues dhe të Shtetit të Kërkuar me dënim me heqje lirie, por disa nga to nuk i përmbushin kushtet në aspektin e masës së dënimit të përcaktuar nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Shteti i Kërkuar ka të drejtën të lejojë ekstradimin për veprat e fundit penale.

Refuzimi i Ekstradimit Neni 7

(1) Ekstradimi nuk lejohet:

1. për personat të cilët janë shtetas të Shtetit të Kërkuar në ditën kur është marrë vendimi për kërkesën për ekstradim;
2. për personat të cilët gëzojnë të drejtën e azilit në territorin e Shtetit të Kërkuar;

3. nëse vepra penale për të cilën është kërkuar ekstradimi konsiderohet nga Shteti i Kërkuar si vepër penale politike ose si një vepër e lidhur me veprën penale apo vepra penale që ekskluzivisht ngërthen shkelje të detyrave ushtarake;
 4. nëse ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit është parashkruar sipas ligjit të Shtetit të Kërkuar;
 5. nëse personi, ekstradimi i të cilit kërkohet, tashmë është dënuar ose liruar për të njëjtën vepër penale me dënim të formës së prerë, ose procedura penale kundër këtij personi përfundimisht është hedhur poshtë, apo akuza kundër këtij personi është hedhur poshtë me vendim të formës së prerë;
 6. në qoftë se është iniciuar procedura penale për të njëjtën vepër penale në Shtetin e Kërkuar ndaj personit ekstradimi i të cilit kërkohet;
 7. në qoftë se procedura penale kundër personit, ekstradimi i të cilit kërkohet, është iniciuar në Shtetin Kërkues nga një gjykatë e jashtëzakonshme ose në qoftë se dënimi është shqiptuar nga një gjykatë e tillë;
 8. në qoftë se ka baza të vërtetuara për të konkluduar që ekstradimi kërkohet për qëllime të ndjekjes penale ose dënimin e personit të kërkuar në bazë të gjinisë, racës, religjionit, kombësisë, shtetësisë, gjuhës, bindjes politike apo orientimit seksual, apo që pozita e personit të tillë rrezikon të dëmtohet ndjeshëm për ndonjërin nga këto arsye.
- (2) Në qoftë se Shteti i Kërkuar nuk ekstradon shtetasin e saj me qëndrim të përhershëm në territorin e Shtetit të Kërkuar, me kërkesë të Shtetit Kërkues, do ta dërgoj rastin tek autoritetet e saja kompetente për iniciimin e procedurës penale. Për këtë qëllim, shkresat, të dhënat dhe dëshmitë që lidhen me veprën penale duhet të dërgohen në mënyrën e paraparë në Nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje. Shteti Kërkues njoftohet për vendimin e autoriteteve kompetente të Shtetit të Kërkuar.
- (3) Vepra penale kundër jetës, duke përfshirë atë në tentativë apo pjesëmarrje, apo ndonjë vepër tjetër penale që sipas rrethanave, dhe veçanërisht sipas mënyrës në të cilën është kryer, mjeteve të përdorura ose për kërcënim, apo seriozitetin e pasojave të shkaktuara apo të pritura, që është më shumë e natyrës penale sesa asaj politike, nuk konsiderohen të jenë vepër penale politike.

Neni 8

Ekstradimi mund të refuzohet:

1. në qoftë se vepra për të cilin kërkohet ekstradimi është kryer në territorin e Shtetit të Kërkuar, kundër këtij shteti ose kundër një shtetasi të tij;
2. nëse kundër personit, ekstradimi i të cilit kërkohet, tashmë është filluar procedura penale në Shtetin e Kërkuar për një tjetër vepër penale dhe Shteti i Kërkuar konsideron se, në interes të sigurimit të gjendjes faktike ose shqiptimit apo ekzekutimit të dënimit, do të jetë e rrugës që t'i gjykoj të gjitha veprat penale në Shtetin e Kërkuar.

Amnistia Neni 9

Ekstradimi nuk lejohet për një vepër penale për të cilën është shpallur amnisti apo falje në Shtetin e Kërkuar, dhe për të cilin Shteti i Kërkuar ka kompetencë ta ndjek penalisht sipas ligjit të tij penal.

Dënimi në Mungesë Neni 10

Në qoftë se personi i kërkuar është dënuar në mungesë, ekstradimi lejohet në qoftë se Shteti Kërkues ofron garanci të mjaftueshme se personi i kërkuar ka të drejtë në rigjykim për të siguruar të drejtat minimale në mbrojtje.

Ekstradimi i Shtyrë dhe i Përkohshëm Neni 11

(1) Në qoftë se personi i kërkuar është duke u ndjekur penalisht në Shtetin e Kërkuar apo është dënuar në këtë shtet për ndonjë veprë penale tjetër nga ajo që është subjekt i ekstradimit, ekstradimi i lejuar mund të shtyhet deri sa të përfundojnë këto procedura ose, në rast të dënimit, deri sa të ekzekutohet dënimi.

(2) Në qoftë se për shkak të ekstradimit të shtyrë, të cekur në paragrafin 1 të këtij neni, ndjekja penale në Shtetin Kërkues është parashkruar ose procesi është penguar në masë të madhe, mund të lejohet ekstradimi i përkohshëm me qëllim të zhvillimit të procedurës penale në bazë të një kërkesë të bazuar nga ana e Shtetit Kërkues, në qoftë se personi i ekstraduar kthehet posa të kryhen veprimet e nevojshme procedurale për të cilat është lejuar ekstradimi i përkohshëm.

(3) Shteti Kërkues duhet ta paraburgos personin e ekstraduar përkohësisht deri sa ai është në territorin e tij. Periudha e paraburgimit, nga dita kur personi i ekstraduar përkohësisht ka dal nga territori i Shtetit të Kërkuar deri në ditën kur ai kthehet, duhet të përfshihet në dënimin e shqiptuar ose duhet të ekzekutohet në Shtetin e Kërkuar.

Disa Kërkesa për Ekstradim Neni 12

(1) Në qoftë se ekstradimi kërkohet në të njëjtën kohë nga më shumë se një shtet, për të njëjtën veprë ose vepra të ndryshme, Shteti i Kërkuar merr vendim se cilit shtet do të ja lejojë ekstradimin, duke marr parasysh të gjitha rrethanat e rastit dhe veçanërisht seriozitetin relativ dhe vendin e kryerjes së veprave, datat përkatëse të kërkesave për ekstradim, shtetësinë e personit të kërkuar dhe mundësinë e ekstradimit të mëvonshëm në një shtet tjetër.

(2) Shteti i Kërkuar njofton Shtetet tjera Kërkuese për vendimin sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe mund t'i njoftojë ato që në të njëjtën kohë jep pëlqimin për çdo ekstradim të mundshëm të mëtejshëm të personit nga shteti kërkesa e të cilit për ekstradim i është lejuar tek një shtet tjetër që gjithashtu ka kërkuar ekstradimin.

Paraburgimi në Procedurat e Ekstradimit Neni 13

Nëse janë plotësuar kushtet formale për ekstradim, Shteti i kërkuar, pasi të ketë marrë kërkesën për ekstradim, mund të paraburgos personin në përputhje me legjislacionin e saj, vetëm nëse ekstradimi nuk mundet të jepet në pajtim me këtë Marrëveshje.

Arrestimi i Përkohshëm Neni 14

(1) Me kërkesë të përshpejtuar të një autoriteti kompetent të Shtetit Kërkues, personi mund të ndalohet përkohësisht para se Shteti i Kërkuar pranon kërkesën për ekstradim, nëse autoriteti

kompetent gjyqësor i referohet urdhrorit për ndalim ose dënimit të formës së prerë dhe paraqet kërkesë për ekstradim. Gjithashtu kërkesa duhet të përmbajë informacione mbi veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës së tillë, informacion mbi dënimin e propozuar ose shqiptuar apo pjesën e mbetur për tu vuajtur dhe, për aq sa është e mundur, një përshkrim të personit të kërkuar.

(2) Kërkesa e cekur në paragrafin 1 të këtij neni mund të dërgohet me postë, telefaks ose mjete të tjera të komunikimit me shkrim ose nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

(3) Shteti i Kërkuar njofton menjëherë Shtetin Kërkues që personi është ndaluar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

(4) Nëse kërkesa për ekstradim dhe dokumente mbështetëse, nga neni 4 i kësaj Marrëveshje, nuk pranohet nga ana e Shtetit të Kërkuar në afat prej 18 ditësh pas arrestimit, arrestimi i përkohshëm mund të ndërpritet. Arrestimi i përkohshëm mund të vazhdohet në bazë të kërkesës së bazuar nga Shteti Kërkues, por në asnjë rast nuk duhet të kalojnë 40 ditë nga dita e arrestit të tillë.

(5) Ndërprerja e arrestit të përkohshëm nuk pengon ri-arrestimin dhe ekstradimin në rastin e një kërkesë të mëvonshme për ekstradim.

Vendimi mbi Kërkesën për Ekstradim Neni 15

(1) Shteti i kërkuar duhet të vendosë mbi kërkesën për ekstradim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të njoftoj Shtetin Kërkues për vendimin e tij.

(2) Duhet dhënë arsye për çdo refuzim të plotë ose të pjesshëm.

Ekstradimi i Thjeshtuar Neni 16

Procedura e thjeshtuar për ekstradim duhet të rregullohet me ligjin vendor të Shtetit të Kërkuar, në bazë të pëlqimit të personit të kërkuar dhe marrëveshjen e Shtetit të Kërkuar.

Kërkesa Pasuese për Ekstradimin Neni 17

Kur personi i ekstraduar shmang ndjekjen penale ose ekzekutimin e dënimit dhe është në territorin e Shtetit të Kërkuar, personi i tillë mund të ekstradohet pas kërkesës pasuese. Në raste të tilla, dokumentet nga neni 4 i kësaj Marrëveshje nuk kanë nevojë të përfshihen në kërkesë.

Dorëzimi i Personit për Ekstradim Neni 18

(1) Nëse lejohet ekstradimi, Shteti Kërkues njoftohet për vendin dhe datën e dorëzimit dhe për kohëzgjatjen për të cilën personi i kërkuar është ndaluar në procedurën e ekstradimit.

(2) Me përjashtim siç parashihet në paragrafin 3 të këtij neni, nëse personi nuk merret në dorëzim në datën e caktuar, ai mund të lirohet pas një afati prej 15 ditësh, dhe duhet në çdo rast të lirohet pas një afati prej 30 ditësh. Shteti i Kërkuar mund të refuzoj të ekstradoj personin për të njëjtën vepër penale.

(3) Palët njoftojnë njëra tjetrën lidhur me rrethanat përtej kontrollit të tyre të cilat ua që ta dorëzojnë apo ta marrin në praninë personin që duhet ekstraduar. Të dyja Palët bien dakord për një datë të re për dorëzim dhe zbatohen dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni.

(4) Eskorta e ngarkuar me transferimin e personit i cili ekstradohet për në ose nga territori i Palës tjetër ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në territorin e Palës tjetër për t'ia pamundësuar këtij personi që të largohet para dorëzimit të tij/saj ose pas marrjes në dorëzim të tij/saj.

Parimi i Specialitetit Neni 19

(1) Personi i cili është ekstraduar nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës, dënohet apo të privohet nga liria apo ekstradohet tek një shtet i tretë për ndonjë veprë të kryer para dorëzimit të tij/saj të ndryshme nga ajo për të cilën është ekstraduar.

(2) Nuk mund të shqiptohet asnjë dënim më i rreptë ndaj personin e ekstraduar përveç atij për të cilin është dënuar.

(3) Kufizimet nga paragrafi 1 pushojnë:

1. nëse personi i cili është ekstraduar shprehimisht heq dorë nga garacioni i cekur në paragrafin 1 të këtij neni;

2. në qoftë se personi i ekstraduar nuk ka lënë territorin e shtetit në të cilin është ekstraduar brenda 45 ditësh nga dita e lirimit përfundimtar, pavarësisht mundësisë për ta bërë këtë, ose në qoftë se personi i tillë pas largimit është kthyer vullnetarisht në këtë shtet;

3. nëse Shteti i Kërkuar jep pëlqimin. Kërkesa për pëlqim duhet të përfshijë dokumentet nga nenin 4 dhe regjistrimet ligjore të ndonjë deklarate të bërë nga personi i ekstraduar në lidhje me veprën penale në fjalë. Pëlqimi nga Shteti i Kërkuar jepet atëherë kur përmbushen kushtet për ekstradim në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje në rastin konkret.

(4) Heqja dorë nga parimi i specialitetit duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të dëshmoj se personi në fjalë ka vepruar vullnetarisht dhe me vetëdije të plotë për pasojat ligjore. Për këtë qëllim, personi i arrestuar ka të drejtë në këshilltar ligjor. Nëse është e nevojshme, Shteti i Kërkuar do të siguroj që personi të ketë ndihmën e një përkthyesi.

Përfshirja e Periudhës së Paraburgimit në Dënim Neni 20

Nëse personi i ekstraduar është mbajtur në Palë për veprën penale për të cilën është ekstraduar, kohën të cilën e ka kaluar në paraburgim do t'i llogaritet në dënim.

Dorëzimi i Sendeve Neni 21

(1) Sendet, dokumentet e shkruara dhe shkresat e lëndës mund të konfiskohen dhe t'i dorëzohen Palës tjetër vetëm në përputhje me ligjin e Shtetit të Kërkuar pas kërkesës dhe vendimit të autoritetit kompetent të Shtetit Kërkues.

(2) Shteti i Kërkuar mund të shtyj dorëzimin e sendeve, dokumenteve të shkruara ose shkresave të lëndës nëse ato nevojiten për procedura penale në pritje.

(3) Pas përfundimit të procedurës për të cilën janë kërkuar sendet, dokumentet e shkruara ose shkresat e lëndës, Shteti Kërkues ia kthen ato Shtetit të Kërkuar, përveç nëse Shteti i Kërkuar i refuzon ato.

Neni 22

(1) Në qoftë se është lejuar ekstradimi i një personi pa ndonjë kërkesë të veçantë, atëherë do të aprovohet edhe dorëzimi i sendeve:

1. të cilat mund të kërkohen si prova;
2. të cilat janë fituar si rezultat i veprës penale ose duke shitur sende me origjinë nga vepra penale.

(2) Nëse ekstradimi i cili do të ishte i pranueshëm në pajtim me këtë Marrëveshje, nuk është i mundur për shkak se personi që do të ekstradohej ka ikur, ka vdekur ose nuk mund të gjurmohet në territorin e Shtetit të Kërkuar, dorëzimi i sendeve megjithatë do të miratohet.

(3) Duhet të ruhen të drejtat e Shtetit të Kërkuar ose personave të tjerë që kanë të bëjnë me sendet. Në funksion të këtyre të drejtave, pasi të kenë përfunduar procedurat, Shteti Kërkues i kthen këto objekte tek Shtetit i Kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur dhe pa pagesë. Kur personat e tillë kanë vendbanimin ose vendqëndrimin në territorin e Shtetit Kërkues, sendet do t'i kthehen direkt personave të tillë, pasi të merret pëlqimi i Shtetit të Kërkuar.

(4) Rregulloret mbi importin dhe eksportin e sendeve dhe të valutave të huaja nuk do të zbatohen për dorëzimin e sendeve sipas këtij neni.

(5) Nëse arrihet pajtim me Palën tjetër, dorëzimi i sendeve që do t'i kthehen palës së dëmtuar mund të kryhet edhe para se personi përkatës është ekstraduar, nëse Pala tjetër pranon t'ia kthejë sendet direkt palës së dëmtuar.

Zbatimi i së Drejtës Procedurale dhe Njoftimet Neni 23

(1) Përveç kur parashihet ndryshe nga kjo Marrëveshje, ligji i Shtetit të Kërkuar do të zbatohet për procedurat për ekstradim dhe paraburgim në territorin e Shtetit të Kërkuar.

(2) Nëse personi ekstradohet për ndjekje penale, Shteti Kërkues njofton Shtetin e Kërkuar për rezultatin e procedurës penale dhe i dërgon vendimin e formës së prerë.

Tranziti Neni 24

(1) Në rast se personi që ekstradohet tek një Palë përmes një shteti të tretë duhet të transferohet përmes territorit të Palës tjetër, transferimi lejohet pas paraqitjes së kërkesës përmes rrugëve nga neni 2 i kësaj Marrëveshje, me kusht që vepra në fjalë nuk do të konsiderohet nga Shteti i Kërkuar që lejon transitin të jetë vepër politike apo ushtarake dhe se personi nuk është shtetas i Shtetit të Kërkuar për lejim të tranzitit.

(2) Kërkesa për tranzit duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e cekura në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

(3) Pala nëpër territorin e së cilës do të transferohet personi mund të mos e ndjekë këtë person penalisht për një vepër penale të kryer para tranzitit dhe as të mos ekzekutojë ndonjë dënim ndaj personit të tillë pa pëlqimin e shtetit ekstradues.

Neni 25

(1) Nëse ekstradimi i një personi kërkon tranzitin nga një vend i tretë për tek Pala nëpërmjet transportit ajror mbi territorin e Palës tjetër, pa aterim të ndërmjetësuar, nuk nevojitet autorizim të Palës për të shfrytëzuar hapësirën ajrore të tij. Shteti Kërkues njofton këtë shtet paraprakisht se është nxjerrë një nga dokumentet sipas paragrafit 3 të nenit 4, dhe se personi

që transferohet nuk është shtetas i Palës hapësira ajrore e të cilit duhet shfrytëzuar, dhe se personi nuk është ndjekur penalisht për një vepër penale politike ose ushtarake.

(2) Në rast të një uljeje të paplanifikuar, njoftimi i tillë do të ketë efektin e një kërkesë për arrest të përkohshëm, siç ceket në nenin 14.

Shpenzimet Neni 26

(1) Shpenzimet që lidhen me ekstradimin mbulohen nga Pala në territorin e së cilës ato ndodhin.

(2) Shpenzimet që lidhen me transitin mbulohen nga Shteti Kërkues.

(3) Shpenzimet që lidhen me transportin ajror mbulohen nga shteti që ka sugjeruar këtë mënyrë të transportit.

Dispozitat Përfundimtare Neni 27

Kjo Marrëveshje nuk cenon asnjë detyrim të palëve që rrjedh nga traktatet ndërkombëtare.

Neni 28

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë pas zbatimit ose interpretimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve ndërmjet autoriteteve kompetente ose nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Hyrja në fuqi, Ndryshimi dhe Ndërprerja Neni 29


(1) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të ardhshëm pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike që janë përfunduar procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

(2) Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund të ndërpresë Marrëveshjen duke njoftuar me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të ndërpritet gjashtë muaj pas marrjes me shkrim të njoftimit lidhur me ndërprerjen.


(3) Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë me marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve. Çdo amendament i tillë do të hyjë në fuqi në përputhje me procedurën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Nënshkruar në SLOVENI më 28.10.2016 në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, serbe, sllovene dhe angleze, të gjitha njëllor autentike. Në rastin e interpretimit të ndryshëm, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS


Dhurata Hoxha
Ministre e Drejtësisë

PËR REPUBLIKËN E SLLOVENISË


mag. Goran Klemenčič
Ministër i Drejtësisë

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 04-223/5
Data / Datum / Date: 26 / 04 / 2023
Shtojca / Dodaci / Annex: -3-

PRISHTINE/A



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
ZYRA E KRYEMINISTRIT - UREDI PRAEMIERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR

Nr. Dërgimit / No. of Copy: 02-1-a
Nr. Dërgimit / No. of Copy: 311/7
Nr. Dërgimit / No. of Copy: -3-
Data / Datum / Date: 26 / 04 / 2023
Prishtinë/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Dt. / / 2023

Nr: / 2023

**DEKLARATA PËR LEKTURIM DHE HARMONIZIM GJUHËSOR PËR PROJEKTLIGJIN
PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
REPUBLIKËS SË SLLOVENISË MBI EKSTRADIMIN**

Në zbatim të nenit 71, paragrafi 1.4. të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, deklaroj se Projektligj për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë mbi Ekstradimin, ka kaluar nëpër procesin e lekturimit dhe harmonizimit gjuhësor në përputhje me kërkesat procedurale që parashihen me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me respekt,

Anita Kalandari
ZV. Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë

Bahri Beqiri
Drejtor i Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë

Hamdi Gela
Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike në Ministrinë e Drejtësisë